



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHITIME
Nr.01-060/01-13784/21 datë:17.06.2021



Npi – 01/179 datë: 28.06.2021

Duke u bazuar në nenin 12 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenit 10, 11 dhe 12 të Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Studentë 01Nr.06/570-60 të datës, 30.03.2012, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 28.06.2021, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E KONKURSIT Nr.05/272 Dt. 16.06.2021 PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË SHITIMES PËR VITIN AKADEMIK 2020/2021 DHE SHPALLJEN E KONKURSIT TË RI

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 28.06.2021, me shumicën e votave aprovoi Vendimin për anulimin e Konkursit Nr.05/272 dt. 16.06.2021 për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Shtimes për vitin akademik 2020/2021.

II

Kuvendi i Komunës autorizon Drejtorinë Komunale të Arsimit, që të shpallë Konkurs të ri për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2020/2021, duke marrë parasysh, Rekomandimin e Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport Npi – 01/174 datë: 24.06.2021, si dhe të merren parasysh propozimet e anëtarëve të Kuvendit si vijon:

1. "Është e rekomanduar që dokumentacionit të ja bashkëngjiteti edhe dokumentin që i vërteton notat e marra nga viti paraprak", Dhe propozimi i dytë, 2. Te pika e gjashtë të përmirësohet dhe të shkruhet "Fakulteti Filologjik".

III

Kuvendi i Komunës ka marrë për bazë edhe rekomandimin nga Komiteti për Politikë dhe Financa, Npi – 01/172 dt.22.06.2021, dhe të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Npi-01/174 dt.24.06.2021.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryesueses së Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj